



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0523-A0001

Në çështjen juridike të:

Paditësi/ankuesi

Sh Rr I , Prishtinë, përfaqësuar nga S K S Avokate, Prishtinë.

Kundër:

Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Prishtinë.

E paditura

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtarë gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJSK-së C-IV.-14-4967, të datës 24 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë i DHPGJSK-së, C-IV.-14-4967, i datës 24 gusht 2022.**
- 3. Asnjëra palë nuk ka të drejtë në rimbursimin e shpenzimeve procedural.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 26 qershor 2014, paditësi përmes postës parashtror ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN093-0014 të datës 03 qershor 2014, me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit ndaj NSH "Gërmia" (në Likuidim).

Me urdhrin e dt. 17 dhjetor 2021, Shkalla e I-rë kishte kërkuar nga paditësi në piken 1 që brenda afatit prej 7 ditsh ta korrigoj dhe plotësoj ankesën, dhe ta bashkëngjis edhe vendimin

e kundërshtuar me ankesë dhe në piken 2 ishte urdhëruar që brenda afatit prej 15 ditësh të paraqitet në zyrën e regjistrimit në mënyrë që bëjë pagesën e taksës gjyqësore në shume prej 20 euro, duke e njoftuar atë se nëse taksa nuk paguhet brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr, në bazë të nenit 253.5 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Urdhri i Gjykatës ishte pranuar nga paditësi me 28 dhjetor 2021, mirëpo ai nuk e kishte bërë pagesën e taksës gjyqësore.

Përmes parashtresës së dt. 10 janar 2022, përfaqësuesja e paditësit ka kërkuar një afat shtesë për ta bërë plotësimin e padisë sipas urdhrit të Shkallës së I-rë, në mënyrë që të sigurojë vendimin e kundërshtuar, pasi që paditësi kishte vetëm vërtetimin me të cilin figuron se ia ka qenë punëtor i ndërmarrjes Shoqërore "Gërmia", vendimin e përkohshëm mbi vazhdimin e asistencës sociale nr. 636, dt. 06.06.2001 dhe formularin e krekës së paditësit të paraqitur tek Autoriteti i Likuidimit dt. 07 shtator 2007. E njëjta i ka bashkangjitur parashtresës dokumentet e cituar në fjalë.

Me 13 janar 2022, e paditura ka paraqitur mbrojtje në ankesën e paditësit dhe i ka propozuar Gjykatës që kërkesën e paditësit ta refuzoj si të papranueshme apo të pabazuar dhe ta vërtetojë vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me 24 janar 2022, përfaqësuesja e paditësit i është përgjigjur urdhrit të gjykatës të dt. 17 dhjetor 2021 dhe ka bashkangjitur vendimin e kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit PRN093-0014, dhe autorizimin për përfaqësimin e paditësit.

Me 24 gusht 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJSK-së, kishte marrë Aktvendimin C-IV.-14-4967, me të cilin ankesa e paditësit konsiderohet e tërhequr.

Në arsyetim të vendimit thuhet se paditësi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjisë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar. Kishte konstatuar se dispozita e nenit 253.5, parsheh: "*Në qoftëse se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr*". Po ashtu Shkalla e I-rë kishte konstatuar se taksat gjyqësore aplikohen sipas udhëzimit të KGJK-së nr.01/2017, lidhur me taksat gjyqësore. Shkalla e I-rë kishte konstatuar se paditësi e kishte pranuar urdhrin për pagesën e taksës gjyqësore por ai nuk e kishte paguar atë, prandaj për këtë arsye ishte konsideruar kërkesa e paditësit e tërhequr. Me 14 shtator 2022, paditësi përmes përfaqësueses së saj kishte parashtruar kërkesë për

kthim në gjendje të mëparshme. Me 19 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJSK-së, me Aktvendimin C-IV.-14-4967, e kishte refuzuara si ta pabazuar propozimin e paditësit për kthim në gjendje të mëparshme.

Me 16 shtatore 2022, paditësi përmes përfaqësues së saj ka parashtruar ankesë kundër aktvendimit C-IV.-14-4967 të datës 24 gusht 2022, me të cilin ankesa e paditësit ishte konsideruar e tërhequr. Në ankesën e parashtruar, thekson se paditësi ankesën e kishte dorëzuar vet dhe në kohën e dorëzimit nuk ka qenë përfaqësues e autorizuar e tij në bazë të autorizimit. Vet paditësi e kishte pranuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore me dt. 29.12.2021. Ka shtuar se paditësi është në moshë të shtyrë dhe se i njëjti me rastin e pranimit të vërejtjes nuk e ka njoftuar që nuk e ka bërë pagesën e taksë gjyqësorë. Pra paditësi ka dashur ta paguaj taksën gjyqësore, por ka harruara ta paguaj atë dhe vetëm kur e ka pranuar Aktvendimin e kundërshtuar i është kujtuar lidhur me pagesën e taksës gjyqësore. I ka propozuar Gjykatës që ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ta prish Aktvendimin e kundërshtuar.

Më 12 dhjetor 2023, Kolegji i Apelit këtë ankesë i'a ka dërguar të paditurës për përgjigje.

Në përgjigjen e datës 21 dhjetor 2023, e paditura i kundërshton pretendimet ankimore të paditësit dhe i propozon kolegjit të ankesave që ta aprovojë përgjigjen në ankesë të paditurës, dhe ta vërtetoj Aktvendimin e atakuar, si vendim të ligjshëm dhe të drejtë dhe ta refuzojë ankesën e ankueses si të pa bazuar në ligj. AKP-ja në mbrojtjen e saj thekson se lidhur me argumentet e Ankesës është qartësisht dhe mjaftueshmërisht i sqaruar në mbrojtjen e parashtruar në Aktvendimin me nr.C-IV.-14-4967 nga DHPGJS, përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishte e padobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtare i parashtron Kolegjit të Ankesave që t'i referohet Mbrojtjes dhe aktvendimit përkatës.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e paditësit është e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

## **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Kolegji i Apelit vëren se paditësi më 07 shtator 2007, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të N.SH "Gërmia" ( në likuidim), një kërkesë për kompensim të pagave në shumë prej 1,500.75 euro, ( shih formularin e kërkesës tek AL) e cila kërkesë është refuzuar si e pa bazuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktvendimin C-IV.-14-4967, të dt. 24 gusht 2022, ankesën e paditësit e ka konsideruar të tërhequr për arsye se paditësi nuk e kishte paguara taksën Gjyqësore edhe pse kishte për obligim ta paguajë at brenda afatit prej 15 ditësh.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla I-rë e DHPGJS, përmes Urdhrit të dt. 17 dhjetor 2021, kishte kërkuara nga paditësi që brenda afatit prej 15 ditësh të paraqitet në zyrën e regjistrimit në mënyrë që bëjë pagesën e taksës gjyqësore në shume prej 20 euro, dhe e kishte njoftuar atë se nëse taksa nuk paguhet brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr, në bazë të nenit 253.5 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Urdhri i Gjykatës ishte pranuar nga paditësi më 28 dhjetor 2021, mirëpo ai nuk e kishte bërë pagesën e taksës gjyqësore.

Kolegji i Apelit vlerëson se pretendimet e paditësit nuk janë relevante dhe të asaj natyre që do të ndikonin në vendosje ndryshe.

Kolegji i Apelit vlerëson se sipas nenit 253.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK): "Paditësi ka për detyrë që padisë t'ia bashkëngjisë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar".

Më tutje, neni 253.5 thotë që: "Në qoftëse paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata dhe nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr".

Kolegji i Apelit vëren se paditësit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Paditësi ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të DHPGJS-së në lidhje me udhëzimin e KGJK-së Nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditësit është refuzuar si e pa bazuar, ndërsa është vërtetuar Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në

ligj.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### **Taksa gjyqësore**

Ankuesi tash më e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore më datë 26 tetor 2022 në shumë prej 20 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji I Apelit I DHPGJS-së më 14 mars 2024.

Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar, Gjyqtar kryesues \_\_\_\_\_